




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 29.12.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.12.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1386, të datës 15.12.2016, paraqitur nga Drejtoria e Administratës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), nenin 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), dispozitat e Ligjit Kundër Korrupsionit Nr. 2004/34, Strategjinë Kundër Korrupsionit 2013-2017, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 17, nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim, të Projekt-Planit për Integritet në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2017-2019 dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të Projekt-Planit për Integritet në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2017-2019.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e Projekt-Planit për Integritet në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2017-2019, Ekzekutivi i Komunës do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar dhe Shoqërinë Civile, që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, në debatin publik të caktuar për datën: 11.01.2017.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
OPŠTINA KOSOVO-POLJE
KODINJA E KOMUNES - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Idetja Nr. 176

Data/Datum: 30. 12 2016

KODINJA E KOMUNES - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 30.12.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.12.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1359, të datës 15.12.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2017, në shumë të mjeteve financiare prej 165€ për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për vitin 2017, është në kompetencë të Drejtorisë së Financave e Buxhetit.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara, përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës dhe Kishës Ortodokse i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim shfuqizon vendimin Nr. 29, të datës 07.03.2016 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Palëve dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Ministria e Administrimit të Përbashkët
KOSOVA / FUSHË-KOSOVË - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Drejtoria e Administrimit të Përbashkët

Mirënjohje/Refuzim: 01

Data/Datum: 10.01.2017

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 06.01.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.12.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1380, të datës 15.12.2016, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), nenin 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 17, nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim, të Projekt-Planit të veprimit për zhvillimin e fëmijëve në fëmijërinë e hershme në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2017-2019 dhe dërgimin e tij, në procedurën e diskutimit publik

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të Projekt-Planit të veprimit për zhvillimin e fëmijëve në fëmijërinë e hershme në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2017-2019.
2. Drejtoria e Arsimit e cila ka punuar në hartimin e Projekt-Planit të veprimit për zhvillimin e fëmijëve në fëmijërinë e hershme në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2017-2019, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar dhe Shoqërinë Civile, që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, në debatin publik të caktuar për datën: 18.01.2017.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Financave dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Numëri i Aktit: 02
Data e Miratimit: 10.01.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.01.2017

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.12.2016, bazuar në nenin 17, shkronja (e), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për fillimin e iniciativës për shpalljen e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës me rrezik të veçantë mjedisore

1. Për fillimin e iniciativës për shpalljen e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës zona me rrezik të veçantë mjedisore nga Termocentralet e Kosovës në Obiliq dhe Mihja Sipërfaqësore në fshatin Bardh i Madh, prej të cilave qytetarët që jetojnë në komunën tonë kanë pasoja të vazhdueshme të ndotjes së ajrit, tokës dhe ujit.
2. Obligohet, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis që në koordinim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të fillojnë procedurat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi

